LIGJ
Nr. 91/2016

PËR RATIFIKIMIN E DOKUMENTIT NDRYSHUES TË MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE UJËSJELLËS-KANALIZIME, POGRADEC, SI AGJENCI E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT "MBROJTJA MJEDISORE E LIQENIT TË OHRIT, KANALIZIMET, POGRADEC III"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet dokumenti ndryshues i marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ujësjellës-Kanalizime, Pogradec, si agjenci e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit "Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet, Pogradec III", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.9.2016

Shpallur me dekretin nr. 9753, datë 3.10.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
Ministër Shkëlqim Cani
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë, Shqipëri

UK sh.a., Pogradec
Valter Gora, drejtor i përgjithshëm
Rruga e Gurasit
Pogradec, Shqipëri
Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Zgjatje e periudhës së disbursimit
Programi për Mbrojtjen Mjedisore të Liqenit të Ohrit/Pogradec
Faza III (BMZ-nr. 2008 65 204)

Data 25 janar 2016
KfW Banka për Zhvillim
Jan Kleinheinsterkamp
Ref jonë: Khtk
Telefon: +49 69 7431-2594
Faks: +49 69 7531-2547
jan.kleinheisterkamp@kfw.de

Marrëveshje Huaje

Datë:	23 dhjetor 2010
Shumë:	10 milionë euro
BMZ-nr.	2008 65 204
Nr. i llogarisë së huas	6755659

Të nderuar zotërinj,

Me anë të kësaj shkrese i referohemi marrëveshjes së sipërpërmendur të huas dhe shkresës suaj të datës 25 shtator 2015, ku kërkoni zgjatje të afateve të disbursimit. Kemi kënaqësinë t'ju informojmë që mund të plotësojmë kërkesën tuaj dhe kemi marrë miratimin e brendshëm për të mbuluar vetë në këtë rast kostot e rifinancimit dhe për të mos ia ngarkuar ato klientit. Në këtë mënyrë mundësohet vazhdimësia e pandërprerë e punimeve në proces në Pogradec dhe dorëzimi i lëndëve kimike për impiantin e trajtimit të ujërave të zeza pas afatit të disbursimit të 31 dhjetorit 2015.

Pas vonesave, në fillim të zbatimit të projektit, ne jemi dakord me ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes së Huas me fuqi prapavepruese nga 31 dhjetori 2015.

SEKSIONI A
MODIFIKIME TË MARRËVESHJES SË HUAS

Marrëveshja e Huas (BMZ-nr. 2008 65 204) do të ndryshohet si vijon:

Neni 3.3, afati për të kërkuar disbursim do të hiqet dhe do të zëvendësohet si më poshtë:

"KfW-ja mund të refuzojë disbursimin pas 30 dhjetorit 2018. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja mund të zgjasë afatin duke informuar Huamarrësin, me diskrecionin e tij të vetëm".

SEKSIONI B
DISPOZITA SHTESË

1. Kjo shkresë nuk ndryshohet ose tërheq dispozita të tjera të Marrëveshjes së Huas, përveç nëse përcaktohet shprehimisht në këtë shkresë.

2. Dispozitat e nenit 10 (Kosto dhe detyrime publike) neni 11.4 (Pajtueshmëria), neni 13.2 (Adresat), neni 14.3 (Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet) dhe neni 14.4 (Forma e shkruar), neni 14.6 (Ligji i zbatueshëm) dhe 14.8 (Arbitrazhi) të Marrëveshjes së Huas, të datës 23 dhjetor 2010 do të përfshihen në këtë shkresë sikur të ishin përcaktuar plotësisht në këtë shkresë dhe sikur referencat për këto klauzola të marrëveshjes të ishin referenca për këtë shkresë.

Ju lutem, konfirmoni pëlqimin tuaj për ndryshimin e përmendur më sipër, duke nënshkruar në formë të detyrueshme me ligj dhe duke na kthyer kopjet sa më shpejt që të jetë e mundur. Përndryshe, ne mund të mos jemi të aftë të vazhdojmë disburimin e fondeve për këto programe pas kësaj date - me pasojat përkatëse te punimet në proces dhe furnizimet për sa i përket vazhdimësisë dhe pretendimeve të mundshme.

Me respekt,
KfW
(Nënshkrimi)

Dr. Kirk Mildner
Drejtues divizioni
KfW Entwicklungsbank

Jan
Kleimheisterkamp
Drejtues projekti
KfW Entwicklungsbank

Lexuar dhe miratuar:
Tiranë_____2015

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë
Emri:
Titulli:

Tiranë _____2015
_____
Për dhe në emër të UK Pogradec

Emri:
Titulli: